

Nr. Prot

Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më ___/___/ 2015

VENDIMNr. 15, Datë 28 / 09 / 2015**PËR PRISHJEN ME LIKUIDIM NE GJËNDJEN E AFTËSISE PAGUESE TË SHOQËRISË KESH SECURITY SH.R.S.F SH.A.**

Në mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nenet 187, 190, Statutit të shoqërisë KESH sh.a., VKM Nr. 171, datë 25.02.2015 "Për miraimin e planit të rimëkëmbjes financiare të sektorit të energjisë elektrike", shkresën nr. 5094/3 prot. datë 17.09.2015 të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, si dhe relacionit të Administratorit të KESH sh.a., Këshilli Mbiqyrës në mbledhjen e tij të datës 28/09/2015,

VENDOSI:

1. Miratimin e prishjes me likuidim në gjëndjen e aftësisë paguese, të shoqërisë KESH Security Sh.R.S.F. sh.a.
2. Afatet dhe procedurat e likuidimit të shoqërisë KESH Security SH.R.S.F sh.a. të nderlidhen me afatet ligjore të zhvillimit dhe perfundimit me sukses të procedurave të prokurimit për përzgjedhjen e operatorit privat të shërbimit të ruajtjes dhe sigurimit fizik.
3. Ngarkohet Administratori i KESH sh.a., për hartimin dhe nënshkrimin e akteve të nevojshme për likuidimin e shoqërisë KESH Security Sh.R.S.F. sh.a., si parashikuar në neni 190 deri 205 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE E KËSHILLIT MBIKQYRËS
ENTELE ÇIPA**

Alban BEQAJ Anëtar

Aurora ALIMADHI Anëtare

Eduart GJOKUTAJ Anëtar

Irir KEKO Anëtar

Engjëll ÇUÇI Anëtar

8699

07.10.2015

VENDIMNr. 2, Datë 07/10 / 2015**PËR EMËRIMIN E LIKUIDATORIT TË SHOQËRISË KESH SECURITY SH.R.S.F. sh.a.**

Bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nenin 13 të Statutit të shoqërisë KESH sh.a. dhe në Vendimin e Këshillit Mbikqyrës të KESH sh.a., Nr. 15, datë 28.09.2015 "Për prishjen me likuidim në gjëndjen e aftësisë paguese të shoqërisë KESH Security SH.R.S.F. sh.a."

VENDOSA

1. Emërmin e Z. Ermir Veipi, Ekspert Kontabel i Rregjistruar me Licence Nr. 261 date 27.08.2012 dhe Nipt. K81506022D, në detyrën e likuidatorit të shoqërisë KESH Security Sh.R.S.F. sh.a.
2. Likuidatori ushtron të gjitha detyrat e administratorit të shoqërisë si dhe të gjitha detyrat e parashikuara në Titullin i "Likuidimi në gjëndjen e aftësisë paguese" nenet 190 e vijues të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Veprimtaria e tij i nënshtrohet mbikqyrjes nga Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë KESH Security Sh.R.S.F. sh.a.
3. Në zbatim të pikës 2 Vendimit të Këshillit Mbikqyrës Nr. 15, datë 28.09.2015 "Për prishjen me likuidim në gjëndjen e aftësisë paguese të shoqërisë KESH Security SH.R.S.F. sh.a." bilanci përfundimtar i prishjes do të dorëzohet Aksionerit jo më vonë se 30 dite kalendrike nga data e lidhjes së kontratës me operatorin privat për shërbimet që mbulon shoqëria KESH Security Sh.R.S.F. sh.a.
4. Masa e shpërblimit të likuidatorit do të llogaritet në bazë të VKM Nr.197 date 13.04.2007 "Për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentit".
5. Mandati i Likuidatorit fillon në datën e rregjistrimit të këtij Vendimi pranë QKR,
6. Të lirojë nga detyra Administratorin e KESH Security Z. Artur Celibashi,
7. Ngarkohet Administratori i shoqërisë KESH Security Sh.R.S.F. sh.a. Z. Artur Celibashi të depozitojë pranë QKR-së të dhënat lidhur me likuidatorin e parë si parashikuar në nenin 194 të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Per AKSIONERIN E VETEM
ADMINISTRATORI KESH Sh.a.

Agron HETOJA

